



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E VËZHguesve AFATGJATË NGA SHOQATA PËR KULTURË  
DEMOKRATIKE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE  
TË DATËS 30 QERSHOR, 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 03.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

**OBJEKT:** Miratimi i vëzhguesve afatgjatë të paraqitur nga "Shoqata për Kulturë Demokratike" për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor, 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

**V Ë R E N**

Shoqata për Kulturë Demokratike si një prej organizatave jofitimprurëse që operojnë në fushën e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe proceseve elektorale ka në objekt të veprimtarisë së saj, t'u mundësojë shtetasve shqiptarë njohjen e demokracisë, të rindërtimit e të funksionimit të institucioneve demokratike dhe t'i bëjë ato të aftë të ushtrojnë sovranitetin e tyre.



Kjo organizate e cila ka marrë pjesë dhe në proceset e mëparshme zgjedhore, ka paraqitur kërkesën e saj me nr. 5031 prot, datë 31.05.2019 bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 22 (njëzetë e dy) vëzhguesve afatgjatë dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është brenda kushteve dhe kërkesave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4,5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

### **V E N D O S I :**

1. Të miratojë kërkesën e Shoqatës për Kulturë Demokratike për akreditimin e 22 (njëzetë e dy) vëzhguesve afatgjatë për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>

